

Vështrim mbi shqiptarët çamë të Greqisë

Robert Elsie

Çamët, të njohur greqisht si *Tsamides*, janë shqiptarë të cilët banojnë në pjesën më jugore të trevave shqipfolëse. Krahina e tyre, Çamëria, është një zonë malore në kufirin greko-shqiptar. Pjesa më e madhe e Çamërisë ndodhet në rajonin e Epirit grek, i cili përfshin pak a shumë prefekturat e Thesprotisë dhe të Prevezës, por Çamëria përfshin edhe pjesën më jugore të Shqipërisë, d.m.th. zonën e Konispolit.

Kur forcat greke morën Çamërinë dhe Epirin gjatë Luftës Ballkanike të vitit 1912, çamët përfunduan papritmas në Greqi, të shkëputur nga pjesa tjetër e Shqipërisë. Kufiri i ri midis Greqisë në zgjerim dhe Shqipërisë së sapolindur mbeti i pacaktuar për një kohë dhe kjo shkaktoi paqëndrueshmëri politike afatgjatë në rajon. Ngacmime të vogla tradicionale mes të krishterëve dhe myslimanëve, mes grekëve dhe shqiptarëve, u shndërruan në një kërdi të llahtarshme. Kaosi mbretëroi në jug të Shqipërisë dhe në Epir, dhe u derdh shumë gjak. Në memorandumin e tij “*Çështja e Epirit – flijimi i një populli*” Mid’hat bej Frashëri (1880-1949) denoncoi karakterin çnjerëzor të sulmeve greke mbi jugun e Shqipërisë, por sigurisht që u kryen krime të rënda nga të gjitha palët. Mijëra refugjatë shqiptarë u dyndën për në Vlorë ku mbetën të pastrehë në kushte të mjerueshme. Shumë njerëz vdiqën nga tifoja apo thjesht nga mungesa e ushqimit.

Gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër në pranverë të vitit 1913, përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha (Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia, Austro-Hungaria dhe Rusia) nuk arritën të merreshin vesh për çështjen nëse Epiri t’i jepej Shqipërisë apo Greqisë dhe, nëse të ndahej, se ku do të caktohej kufiri. Për këtë arsye, në gusht 1913, Konferenca ngriti një Komision Ndërkombëtar Kufiri (*International Border Commission*) i cili u dërgua në rajon në vjeshtë të atij viti për të ndarë të Pandashmen. Roli vendimtar në caktimin e kufirit duhej të ishte identiteti etnik i popullsisë, por u morën parasysh edhe faktorë të tjerë. Rezultatet e punës së Komisionit u shpallën në Protokollin e Firences, të nënshkruar në dhjetor 1913, i cili e la Çamërinë, me popullatën e saj shumice shqiptare, në anën greke të kufirit. Protokollin e Firences la gjithashtu një pakicë të dukshme greke në anën shqiptare.

Qeveria e re shqiptare nuk ishte në gjendje për të ushtruar ndikimin e saj në jug të vendit dhe, me gjithë Protokollin e Korfuzit të majit 1914, i cili konfirmoi statuskuonë, kontrollin në pjesën më të madhe të jugut të Shqipërisë e kishin *de facto* forcat greke, në rajonin që tanimë quhej Vorioepiri.

Pas sulmit të vitit 1913, Çamëria në anën jugore të kufirit u përfshi drejtpërsëdrejti në shtetin grek. Në verë të vitit 1914, gjatë fillimit të Luftës së Parë Botërore, shteti i ri shqiptar pushoi së ekzistuari kështu që askush nuk mendonte më për kthimin e Çamërisë Shqipërisë. U vendos një administratë e re greke, për të cilën popullata ortodokse greke u gëzua shumë. Por që prej fillimit, veprimet e saj armiqësuan banorët shqiptarë myslimanë, mbase qëllimisht. Gradualisht u bë e qartë se synimi ishte asimilimi i shqiptarëve ortodoksë dhe dëbimi i shqiptarëve myslimanë. Gjatë viteve në vijim, përfshirë periudhën e Luftës së Parë Botërore dhe menjëherë pas asaj, u ushtrua presion në mënyra të ndryshme, si i padukshëm, po ashtu edhe i dhunshëm, për të inkurajuar, edhe madje për të detyruar shqiptarët myslimanë të largoheshin nga Çamëria. Çeta paramilitare, si ajo e Deli

Janakis, sulmuan fshatra shqiptare, frikësuan banorët, dhe qindra të rinj u dëbuan për në kampet në ishujt e Detit Egje. Treva të mëdha u konfiskuan me pretekst të një reforme agrare dhe ish-pronarëve, kryesisht familjeve të pasura shqiptare myslimane iu pagua shumë pak ose aspak kompensim, të cilat nuk shihnin mundësi tjetër përveç emigrimit.

Në janar 1917, trupa italiane pushtuan për një kohë Konicën, Delvinakin dhe Sajadën dhe zëvendësuan administratën greke me një administratë vendore shqiptare. Pas viteve të shtypjes, situata u përmbys, dhe shqiptarët morën hak mbi fshatra greke, të cilat u plaçkitën dhe u dërrmuan.

Pas Luftës së Parë Botërore erdhi Lufta Greko-Turke e viteve 1919-1922, po aq e përgjakshme, rezultati i të cilës ishte një shkëmbin i madh popullate. Sipas Konventës për shkëmbimin e popullsive greke dhe turke, nënshkruar në Lozanë më 30 janar 1923, të krishterët ortodoksë në Turqi, më shumë se një milion sish, duhej të rivendoseshin/dëboheshin për në Greqi, kursi myslimanët me banim në Greqi duhej të rivendoseshin/dëboheshin *en masse* për në Turqi. Përjashtime u lejuan vetëm për banorët grekë të Stambollit dhe për turqit e Trakisë perëndimore. Popullata myslimane shqiptare e Çamërisë dhe të Epirit nuk u përmend fare në Konventë. Në Çamëri u përhapën shumë shpejt thashetheme dhe frikë deri sa më 19 janar 1923 qeveria greke deklaroi se myslimanët shqiptare do të përjashtoheshin nga shkëmbimi i parashikuar. Në rajon u dërgua një komision i përzier i Lidhjes së Kombeve, pa përfaqësim shqiptar, për të përcaktuar prejardhjen e popullatës myslimane. Detyra e komisionit ishte mjaft i ndërlikuar sepse, për shkak të diskriminimit dhe të përndjekjes zyrtare dhe jozyrtare që kishin pësuar, shumë çamë donin të përfshiheshin në shkëmbim, të largoheshin pa kusht. Me gjithë deklaratën e qeverisë greke, shumë të tjerë u detyruan të përgatisnin çantat dhe të iknin për në Turqi. Në tokën e tyre dhe në shtëpitë e tyre u vendosën refugjatët e shumëvujtur grekë nga Anatolia.

Vitet '30 panë një përmirësim të marrëdhënieve midis çamëve shqiptarë dhe shtetit grek, veçanërisht gjatë viteve të fundit të administratës së Kryeministrit Elefthérios Venizélos (1864-1936), por gjendja u përkeqësua dukshëm nga viti 1936 me vendosjen e diktaturës së Ioánnis Metaksás (1871-1941) kur u morën masa të hapëta shtypëse. U ndalua përdorimi i gjuhës shqipe publikisht dhe privatisht, dhe nuk u lejuan më libra dhe gazeta në gjuhën shqipe. Arsimi shqip kishte qenë rreptësisht i ndaluar në Çamëri që prej vitit 1913. Me pretekstin e kërkimit të armëve, policët rregullisht bastisën shtëpi shqiptare dhe rrahën banorët, shpesh duke i arrestuar pa shkak. Edhe gjatë periudhave kur situata ishte më e qetë, shqiptarëve të Çamërisë iu dha të kuptohej se nuk ishin të mirëpritur në Greqi.

Në prill 1939, forcat italiane të diktatorit fashist Benito Mussolini (1883-1945) pushtuan Shqipërinë dhe, brenda pesë ditësh, morën tërë vendin, duke detyruar Mbretin Zog të arratisëj. Me këtë pushtim, Shqipëria humbi pavarësinë e saj dhe u përfshi në Perandorinë e re Romake të Mussolinit. Pak kohë pas kësaj, italianët e drejtuan vëmendjen ndaj Greqisë. Gjatë përgatitjes së fushatës për pushtimin e Greqisë, mëkëmbësi italian i Shqipërisë, Francesco Jacomoni di San Savino (1893-1973), përhapi propagandë për keqtrajtimin e pakicës çame dhe la të kuptohej se, me sundimin italian, gjendja do të ndryshohej, madje se Çamëria mund të ribashkohej më Shqipërinë.

Zbulimi i trupit pa kokë të prijësit rebel Daut Hoxha (1895-1940) ishte një pikë kthesë. Koka e Hoxhës, e prerë siç thoshin nga agjentët grekë, qarkulloi nëpër fshatra te

rajonit për të frikësuar banorët dhe për t'i detyruar të largoheshin. Në gusht 1940, ministri italian i Punëve të Jashtme, Konte Galeazzo Ciano (1903-1944), përdori rastin e vrasjes së Daut Hoxhës për të krijuar një incident të madh diplomatik midis të dy vendeve dhe për të bindur Mussolinin për nevojën e pushtimit italian të Greqisë.

Është e kuptueshme se çamët, pas një çerek shekulli të trajtimit si qytetarë të dorës së dytë në Greqi, nuk kishin pse të kundërshtonin përmbysjen e regjimit grek. Shumë prej tyre ishin të bindur se pushtimi italian do të përmirësonte gjendjen e tyre, dhe, në një farë mase, dëshira e tyre u realizua. Me pushtimin italian të Çamërisë dhe të Epirit në fund të tetorit 1940, situata ndryshoi përsëri për ortodoksët grekë të rajonit, të cilët iu nënshtruan autoritetit, kontrollit dhe persekutimit çam. Në verë të vitit 1942, administrata civile çame me këshillat e saj vendore kishte zëvendësuar pothuajse tërësisht strukturat e mëparshme greke.

Për të mbajtur pushtetin në rajon, autoritetet italiane në Çamëri, dhe gjermanët që pasuan në shtator 1943, bënë çmos për të theksuar dhe për të përforcuar armiqësitë tradicionale etnike midis shqiptarëve, grekëve dhe vlllehëve. Shqiptarët dhe vlllehët, më parë të nënshtruar dhe kokulur, u ngritën, dhe u krijuan njësi policore çame për të sunduar mbi popullatën greke.

Gjatë pushtimit gjerman, erdhi fshehurazi një mision ushtarak britanik për të bindur udhëheqësit çamë të luftonin kundër Gjermanisë, por çamët refuzuan, jo pse donin Gjermaninë naziste, por thjesht sepse e vetmja gjë që iu ofronin britanikët ishte kthimi i sundimit grek.

Me tërheqjen e forcave gjermane në verë dhe në fillim të vjeshtës të vitit 1944, Greqia ndodhej në fazën e parë të një lufte të përgjakshme civile. Për të siguruar bregdetin jonian për furnizimet e tyre ushtarake, forcat britanike lejuan që njësitë e një komandanti vendas grek, gjenerali Napoleon Zervas (1891-1957), të pushtonin rajonin. Zervasi, themeluesi dhe udhëheqësi i Lidhjes Kombëtare Republikane Greke (*Ethnikós Demokratikós Ellēnikós Sýndesmos* – EDES) u bë i njohur për spastrimin brutal etnik të shqiptarëve të Çamërisë nga qershori 1944 deri në mars 1945. Njerëzit e tij i shikonin çamët si bashkëpunëtorë të italianëve dhe të gjermanëve, dhe kërkonin të merrnin hak. Gjatë sulmeve të tyre, gjetën vdekjen disa mijëra burrë, gra dhe fëmijë në Çamëri.

Më 27 qershor 1944, forcat e Zervasit hynë në qytetin e Paramithisë dhe vranë rreth 600 çamë myslimanë – burrë, gra, dhe fëmijë – në një kërde të paparë. Shumë viktima u përdhunuan dhe u torturuan para se të thereshin. Një batalion tjetër i EDES-it pushtoi Pargën të nesërmen ku u vranë 52 shqiptarë. Me 23 shtator 1944, fshati i Spatarit të Filatit u plaçkit dhe 157 persona u vranë. Shumë gra dhe vajza u përdhunuan, dhe u kryen shumë krime të tjera të ullahtarshme. Sipas përlllogaritjes së shoqatës çame të Tiranës gjatë sulmeve të viteve 1944-1945, u vranë gjithsej 2,771 civilë shqiptarë. Menjëherë pas këtyre ngjarjeve, tërë popullata çame, e pambrojtur dhe e tmerruar, mori arratinë dhe iku për në Shqipëri për të shpëtuar.

Këtu dëshiroj të përmend faktin se në vitin 1947, pas Luftës së Dytë Botërore, me gjithë përgjegjësinë për krime lufte dhe me gjithë faktin se ishte vetë i dyshuar për bashkëpunim me nazistët, Napoleon Zervas u emërua ministër i Rendit Publik në qeverinë greke!

Spastrimi i çamëve myslimanë të Greqisë në fund të Luftës së Dytë Botërore shënoi përfundimin e një kapitulli të dhimbshëm të historisë çame dhe fillimin e një tjetri. Vendi ku arritën çamët e raskapitur dhe të uritur, pra Shqipëria, ishte pushtuar pak kohë para ardhjes së tyre, nga Enver Hoxha (1908-1985) dhe forcat e tij komuniste. Udhëheqësit e rinj marksistë nuk u treguan shumë mikpritës apo tërësisht të predispozuar për të ndihmuar bashkatdhetarët e tyre çamë sepse, edhe ata i konsideronin si bashkëpunëtorë me fashistët. Megjithatë, çamëve iu dhanë status si refugjatë dhe u lejuan të qëndronin në Shqipëri. Çamët morën ndihmë jo nga regjimi i Enver Hoxhës, por nga Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Rehabilitim (*United Nations Relief and Rehabilitation Administration, UNRRA*), e cila shpërndau çadra, ushqim dhe ilaç në kampet e mjeruara çame në Vlorë, Fier, Durrës, Kavajë, Delvinë dhe Tiranë. Refugjatët çamë u inkuadruan fillimisht në të ashtuquajtur Komitetin Antifashist i Emigrantëve Çamë, krijuar në vitin 1944 si pjesë e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, udhëhequr nga komunistët.

Gjatë viteve pas Luftës së Dytë Botërore, Komiteti Antifashist i Emigrantëve Çamë bëri fushatë për kthimin e çamëve në vendlindjen e tyre. Duhet theksuar se shumica e tyre nuk donin të rrinin në Shqipëri, veçanërisht duke marrë parasysht spastrimet e tipit stalinist që po zhvilloheshin aty. Komiteti mbajti dy kongrese në vitin 1945, një në Konispol dhe tjetri në Vlorë. Komiteti hartoi memorandume dhe dërgoi telegrame në mbështetje të qëllimeve të tij. Në vitin 1946, Përfaqësuesi i Shqipërisë ngriti çështjen çame në Konferencën e Paqes të Parisit, por të gjitha veprimet rezultuan të pafrytshme. Përpjekjet për të internacionalizuar çështjen çame ranë kryesisht në vesh të shurdhër. Për vite më radhë, çamë vazhduan të shpresonin se situata politike do të qetësohej dhe se ata do të mund të ktheheshin në Greqi. Por kjo nuk u bë. Edhe sot, në shekullin e 21-të, çamët e moshuar që kërkojnë të hyjnë në Greqi për një vizitë kthehen në kufi nga zyrtarët kufitarë grekë. Pasaportët e tyre stampohen me *persona non grata* ose madje grisen para syve të tyre.

Në fillim të viteve '50, çështja çame u konsiderua e mbyllur. Qeveria shqiptare iu dha çamëve nënshtetësinë e detyruar shqiptare dhe e shpërndau Komitetin. Në vitet 1953 dhe 1954, qeveria greke miratoi ligje sipas të cilëve, prona çamë konsiderohej e braktisur dhe kështu ligjërisht e konfiskuar. Nuk kishte për të pasur kthim.

Që prej ngjarjeve tragjike të Luftës së Dytë Botërore kanë kaluar shumë dhjetëvjeçarë. Megjithatë ndër çamët mbetet një ndjenje padrejtësie dhe viktimizimi. Me gjithë marrëdhëniet shumë të mira midis Greqisë dhe Shqipërisë dhe me gjithë marrëdhëniet përgjithësisht miqësore midis popullit grek dhe popullit shqiptar, është pikërisht kjo, arsye pse çështja çame nuk zhduket.

Sot nuk ka pretendime serioze për ndryshimin e kufirit apo për kthimin e rajonit çam Shqipërisë. Pas një shekulli, kufiri i sotëm është botërisht i pranuar si realitet. Atëherë, çfarë duan çamët?

Pas Luftës së Dytë Botërore, çamëve iu mohuan kolektivisht nënshtetësia greke. Humbën pronën dhe u dëbuan nga vendlindja e tyre. Atë që kërkojnë është njohja e padrejtësisë të kryer. Ata duan gjithashtu kthimin e pronës apo të paktën një kompensim për humbjet, dhe shumë prej tyre duan të kthehen në atdheun e tyre çam, pra kthimin e nënshtetësisë greke. Pengesa kryesore në arritjen e këtyre qëllimeve modeste mbetet Ligji grek i Luftës i vitit 1940, i cili faktikisht është ende në fuqi. Për dhjetëvjeçarë me radhë,

autoritetet greke kanë futur kokën si struci në rërë dhe kanë refuzuar të diskutojnë problemet. Ata thjesht mohojnë ekzistencën e çështjes çame, madje edhe ekzistencën e një pakice shqiptare në Greqi.

Në një perspektivë afatgjatë, Evropa duhet të kontribuojë në gjetjen e një zgjidhjeje të çështjes çame. Shpresoj se në të ardhmen, sipas shembullit të Evropës Perëndimore, kufiri midis Greqisë dhe Shqipërisë do të fshihet dhe bëhet i padukshëm. dhe se popujt e të dy vendeve do të mund të vijnë dhe të shkojnë si duan, duke lënë pas hijet e së shkuarës.

[Published in the newspaper *Shqip*, Tirana, 25 November 2012, p. 22-23 / botuar në: gazetën *Shqip*, Tiranë, 25 nëntor 2012, f. 22-23.]